

L I G J
Nr.7521, datë 30.10.1991

**PËR PËRKRAHJEN SOCIALE PËR PERSONAT QË DALIN TË PAPUNË NGA ZBATIMI I
REFORMËS EKONOMIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Personat e punësuar që për shkak të zbatimit të reformës ekonomike humbasin vendet e punës, konsiderohen të papunë dhe përfitojnë të drejtën e përkrahjes sociale e të ndihmës shoqërore, si dhe të ndihmës për aftësimin e tyre profesionale me anë të kualifikimit e të rikualifikimit.

Neni 2

Përfitojnë të drejtën e përkrahjes sociale:

a) Personat që mbeten pa punë nga mbyllja, zvogëlimi e riorganizimi i veprimtarisë së ndërmarrjeve, të institucioneve të organeve shtetërore në qendër e në bazë dhe të partive e organizatave politike e shoqërore të njohura me ligj dhe që kanë vjetërsi pune jo më pak se 3 muaj.

b) Ushtarakët që lirohen nga detyra para kohe si pasojë e riorganizimit të strukturave të reparteve të Ministrisë së Mbrojtjes, të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shëbimit Informativ Kombëtar.

c) Specialistët e lartë të bujqësisë që punonin në kooperativat bujqësore dhe që kanë dalë të papunë nga zvogëlimi, riorganizimi a prishja e kooperativave bujqësore.

ç) Ish të burgosurit politik që janë të papunë me banim në qytete, qendra të banuara e ndërmarrje bujqësore, si dhe ata me banim në fshatra, familje e të cilëve nuk kanë tokë.

KREU II
PËRKRAHJA SOCIALE DHE NDIHMA SHOQËRORË PËR TË PAPUNËT

Neni 3

Përkrahja sociale dhe ndihma shoqërore për personat që mbeten të papunë nga zbatimi i reformës mbështetet në pagën minimale të miratuar nga Këshilli i Ministrave, pagën mesatare mujore të vitit të fundit të punës, si dhe në numrin e pjesëtarëve të familjes që kanë në ngarkim dhe caktohet si vijon :

1. 50 Për qind të pagës minimale të miratuar për personat që kanë vjetërsi punë nga 3 muaj deri në një vit.

2. 70% Për qind të pagës mesatare mujore të vitit të fundit për personat që kanë vjetërsi punë mbi 1 vit.

Për këtë kategori të papunësh kufiri më i ulët i masës së përkrahjes sociale do të jetë 90 për qind të pagës minimale dhe kufiri më i lartë 150 për qind të pagës minimale.

Neni 4

Kur të dy mbajtësit e familjes mbeten të papunë ose njëri mbetet i papunë dhe tjetri është në pension, për çdo person që ata kanë në ngarkim, jepet një ndihmë shoqërore në masën 10 për qind të pagës minimale të miratuar.

Për personat e papunë, familjet e të cilëve kanë tokë, masa e përkrahjes sociale është 25 për qind Për zonat malore e kodrinore dhe 35 për qind për zonat fushore, më e vogël se masa e përcaktuar në nenin 3.

Neni 5

Për të përfituar përkrahje sociale e ndihmë shoqërore personat e parashkuar në këtë ligj duhet të regjistrohen e të bëjnë kërkesë në zyrën e punës dhe të përkrahjes sociale ku kanë vendbanim ose në zyrën e punës e të përkrahjes sociale që ndodhet në territorin e qendrës së punës, ku personat kanë punuar për herë të fundit.

Shuma e përkrahjes sociale dhe e ndihmës shoqërore përcaktohet nga zyra e punës dhe e përkrahjes sociale, në bazë të dokumenteve që do të plotësojnë të interesuarit. Rregullat për plotësimin e dokumenteve përcaktohen nga Komiteti i Punës dhe i Përkrahjes Sociale.

Neni 6

Nuk përfitojnë përkrahje sociale e ndihmë shoqërore:

a) Personat, të cilëve u janë rekomanduar 2 vende pune në përshtatje me moshën, profesionin, nivelin arsimor e gjendjen shëndetësore, ose që u janë rekomanduar nga zyrat e punës të ndjekin kurse kualifikimi e riakualifikimi e që e kanë refuzuar pa arsye rekomandimin.

b) Personat që kanë kushtet për të përfituar pension të plotë pleqërie dhe ushtarakët që përfitojnë pension të pjesshëm.

c) Personat që largohen nga puna me dëshirën e tyre ose për faj të tyre.

Neni 7

Personat e punësuar që mbeten pa punë, kanë të drejtë të marrin përkrahje sociale nga dita e mbetjes pa punë, në rast se regjistrohen në zyrat e punës e të përkrahjes sociale brenda 30 ditëve.

Neni 8

Përkrahja sociale dhe ndihma shoqërore paguhet për një afat prej 12 muajsh. Për 6 muajt e parë masa e përfitimit përcaktohet në nenet 3 dhe 4 të këtij ligji. Për 6 muajt e dytë masa e përfitimit të përkrahjes sociale është 10 për qind më pak.

Mënyra e pagesës së përkrahjes sociale dhe ndihmës shoqërore të personave në ngarkim përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

Për personat që punësohen me ndërprerje gjatë periudhës një vjeçare të përkrahjes sociale, afati i saj mund të shtyhet deri në dy vjet, por me kusht që gjithsej të mos përfitojë më shumë se 365 ditë.

Përfitojnë të drejtën e përkrahjes sociale tej afateve të paragrafit 1 të këtij neni, por jo më shumë se 3 muaj, personat që përkohësisht për shkaqe të gjendjes shëndetësore nuk mund të përfshihen në kurset e kualifikimit e të rikualifikimit.

Neni 9

Periudha, gjatë së cilës një person merr përkrahje sociale njihet si vjetërsi pune e përgjithshme.

Neni 10

Personi, gjatë kohës që merr përkrahje sociale, përfiton edhe ndihma e pensione invaliditeti të gruit III e IV sipas ligjit për sigurimet shoqërore e shtetërore.

Gratë, gjatë kohës së përkrahjes sociale, përfitojnë shpërblim për leje barre lindje sipas ligjit Për sigurimet shoqërore shtetërore. Gjatë periudhës së kësaj leje ato nuk marrin përkrahje sociale.

Personat që marrin përkrahje sociale nuk përfitojnë sigurimet shoqërore për paaftësi të përkohëshme në punë.

Neni 11

Personi që përfiton përkrahje sociale e ndihmë shoqërore është i detyruar që një herë në muaj, mbi bazën e programit të caktuar ose sa herë që thirret, të paraqitet në zyrën e punës dhe të përkrahjes sociale.

Personi që merr përkrahje sociale e ndihmë shoqërore dhe që fillon një veprimtari private ose hyn vetë në marrëdhënie punë, është i detyruar të lajmërojë brenda 5 ditëve zyrën e punës dhe të përkrahjes sociale. Në rast të kundërt ai paguam trefishin e shumës së përfituar.

Çdo person gjatë periudhës që merr përkrahje sociale e ndihmë shoqërore, është i detyruar të informojë zyrën e punës dhe të përkrahjes sociale për ndryshimet në gjendjen familjare.

Neni 12

Masa e përfitimit të përkrahjes sociale e të ndihmës shoqërore, si dhe plotësimi i kërkesave të parashikuara në nenin 11, paragrafi 1 e 2 të këtij ligji, shënohen në librezën e punës, e cila firmoset çdo tre muaj nga zyra e punës dhe e përkrahjes sociale.

Neni 13

Përkrahja sociale e ndihma shoqërore caktohen mujore dhe paguhen përpjesëtimisht me numrin e ditëve kalendarike, për kohën që personi ka të drejtë të marrë atë përkrahje ose ndihmë. Pagesa bëhet në zyrat e punës e të përkrahjes sociale.

Përkrahja sociale dhe ndihma shoqërore nuk tatohen.

Neni 14

Pagesa e përkrahjes sociale dhe e ndihmës shoqërore ndalohet në këto raste:

- a) Kur është dhënë jashtë rregullave të parashikuara në këtë ligj.
- b) Kur personi ka hyrë në marrëdhënie pune ose kur ka filluar një veprimtari private.
- c) Kur ka refuzuar për shkaqe të përligjura 2 vende pune, megjithëse ato i janë dhënë në përshtatje me moshën, profesionin, nivelin arsimor dhe gjendjen shëndetësore.
- ç) Kur refuzon pa u justifikuar vazhdimin e një kursi kualifikimi a rikualifikimi ose, sipas rastit, ndërpret a nuk e mbaron kursin e organizuar pa shkaqe të justifikuara.

Pagesa e përkrahjes sociale dhe e ndihmës shoqërore pezullohet:

- a) Kur nuk plotësohen detyrimet e parashikuara në nenet 11 e 12.
- b) Gjatë kohës së kryerjes së shërbimit ushtarak.
- c) Gjatë kohës kur përfituesi largohet jashtë shtetit
- ç) Gjatë kohës kur personi është arrestuar ose kryen një dënim me heqje lirie.
- d) Gjatë kohës kur personi është në marrëdhënie punë me kontratë për një kohë të caktuar.

Neni 15

Për detyrimet e përcaktuara në këtë ligj, personave u nxirret urdhëri përkatës nga zyra e punës dhe e përkrahjes sociale, i cili është titull ekzekutiv. Këto detyrime nxirren nëpërmjet ndalesave nga paga, kur personat e papunë vendosen në marrëdhënie pune, ose mbi të ardhurat e tyre, kur punojnë privatisht.

KREU III
KRIJIMI DHE PËRDORIMI I FONDIT PËR PAGESËN E PËRKRAHJES E TË NDIHMËS
SHOQËRORE

Neni 16

Fondi i nevojshëm për pagesën e përkrahjes sociale e të ndihmës shoqërore krijohet nga shuma e këtyre burimeve :

a) Nga një kuotë prej 6 për qind mbi fondin e pagave të realizuara çdo muaj nga veprimtaria e ndërmarrjeve, institucioneve, organeve shtetërore, organizatave ekonomike dhe e personave të tjerë juridikë a fizikë vendas a të huaj, që kanë në strukturën e tyre personel shqiptar, si dhe e punëdhënësve të tjerë.

c) Nga kundërvlehtë e ndihmave shtetërore humanitare.

c) Nga buxheti i shtetit kur burimet sipas shkronjave "a" dhe "b" të këtij neni nuk mbulojnë pagesat e detyruara.

Neni 17

Fondi për pagesën e përkrahjes sociale e të ndihmës shoqërore ruhet për llogari të Komitetit të Punës dhe të Përkrahjes Sociale në Bankën e Shtetit Shqiptar dhe përdoret prej tij.

Shumat e përdorura gjatë një periudhe nuk preken. Ato kalojnë në periudha menjëherë pasuese, pa u derdhur në buxhetin e shtetit.

Neni 18

Nga fondi i krijuar në përshtatje me nenin 16 të këtij ligj do të bëhen pagesa edhe për:

a) Mbulimin e shpenzimeve që kryhen për pagesat e përkrahjes sociale e të ndihmës shoqërore.

b) Mbulimin e disa shpenzimeve që lidhen me kualifikimin e rikualifikimin e të papunëve.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19

Rregullat për organizimin e veprimtarisë së përkrahjes sociale e të ndihmës shoqërore, si dhe për ndjekjen dhe kontrollin e saj, caktohen nga Këshilli i Ministrave,

Neni 20

Punëdhënësit shtetëror ose private kanë për detyrë të njoftojnë në zyrat e punës dhe të përkrahjes sociale për të gjitha vendet e lira brenda 10 ditëve të krijimit të tyre, kurse zyrat e punës e të përkrahjes sociale kanë për detyrë të mbajnë evidencë e t'i shpallin vendet e lira të punës.

Neni 21

Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të qendrave të kualifikimit e të rikualifikimit të personave që marrin përkrahje sociale e ndihmë shoqërore, caktohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 22

Ndaj punonjësve të zyrave të punës dhe të përkrahjes sociale që shkelin të drejtat e personave që përfitojnë nga ky ligj kur ato nuk përbëjnë vepër penale, merren masa disiplinore sipas kodit të punës.

Neni 23

Mosmarrëveshjet që lidhen me përcaktimin dhe pagesën e përkrahjes sociale zgjidhen nga gjykata.

Neni 24

Për organizimin, ndjekjen dhe pagesën e përkrahjes sociale e të ndihmës shoqërore, seksionet e punës në aparatet e komiteteve ekzekutive të rretheve e rajoneve riorganizohen në zyra të punës dhe përkrahjes sociale jashtë strukturës ekzistuese të komiteteve ekzekutive të rretheve e rajoneve.

Keto zyra janë në vartësi të Komitetit të Punës dhe Përkrahjes Sociale, si dhe të organeve të Pushtetit lokal.

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi më 1.11.1991

Shpallur me dekretin nr.68, datë 5.11.1991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Ramiz Alia